



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 03

Datë: **23. 01. 2024.**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. **Hyrje: Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ**
2. Plotësim – ndryshimi i vendimit për pjesëmarrje të KQZ në Varsashavë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarësimit të KQZ-së në Rrjetin Nacional të Frankofonisë.
4. Të ndryshme!

1. Hyrje: Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ:

Fillimisht, kryetari **Kreshnik Radoniqi** e ka paraqitur dy pikat e agjendën e kësaj mbledhje. Anëtarët e KQZ-së, e kanë miratuar rendin e ditës. Në vazhdim, u shqyrtuan pikat e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim – ndryshimi të vendimit për pjesëmarrje të KQZ në Varshavë:

Kreshnik Radoniqi: Kemi marrë një ftesë nga ODIRI për pjesëmarrje në konferencën “Shkëmbimi rajonal mbi forcimin e sistemeve dhe praktikave financiare të fushatës” (Regional Exchange on Strengthening

Campaign Finance Systems and Practices), që mbahet më 21-22 shkurt në Varshavë të Polonisë. Ftesa, ka ardhur në emër të Besnikut, drejtor i zyres. Këtë pikë e kemi shqyrtuar në mbledhjen e fundit të Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë. Nuk kemi vendosur si këshill, mirëpo e kemi lënë që kjo të miratohet në takimin e KQZ-së, qoftë aspekti i pjesëmarrjes, dhe qoftë aspekti i miratimit. Në këshill, kemi vlerësuar se, është me rëndësi pjesëmarrja jonë si KQZ.

Anëtarët e KQZ-së pjesëmarrës në këtë takim “on line”, pas diskutimeve dhe shqyrtimit kanë aprovuar pjesëmarrjen e KQZ-së, dhe kanë miratuar përfaqësimin në konferencë të: z. Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-sw, dhe Besnik Buzhales e Margita Kryeziut nga Zyra.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarësimit të KQZ-së në Rrjetin Nacional të Frankofonisë:

Kreshnik Radoniqi: Gjithashtu, ka thënë z. Radoniqi, këshilli ka shqyrtuar edhe një pikë tjetër, në të vërtetë një propozim për anëtarësim të KQZ-së në Rrjetin Nacional të Frankofonisë. (RECEF) Kemi komunikuar edhe më herët dhe na janë dërguar edhe procedurat për anëtarësimin e KQZ-së. Jam takuar edhe personalisht me përfaqësuesin e Presidentes së Frankofonisë, z. Shemsi Krasnqi, ka shpjeguar z. Radoniqi. Shuma vjetore që duhet paguar është 2500 dollar kanadez, ose 1750 euro.

Ka pasur mendime të ndryshme për dhe kundër, por e kemi lënë të vendoset në mbledhje të KQZ.

Anëtarët e KQZ-së, kanë miratuar propozimin për anëtarësimin e KQZ-së në Rrjetin Nacional të Frankofonisë.

4. Të ndryshme!

P.s

Kjo mbledhje është mbajtur “On – line”.